

**HIDRO ONE ENERGY**


**PERMBLEDHJA JO TEKNIKE E  
RAPORTIT TE VLERESIMIT TE  
NDIKIMIT NE MJEDIS  
PER AKTIVITETIN E NDERTIMIT DHE  
FUNKSIONIMIT TE HEC-ve  
DOHOSHISHT 2&3**

(Sipas Ligjit nr.10 440 date 07.07.2011 "Per vleresimin e ndikimit ne mjedis" Shtojca 2 Kodi 3/2)



**Vendndodhja e ushtrimit te aktivitetit : Fshati Dohoshisht, Peshkopi**

**INVESTITOR : HIDRO ONE ENERGY shpk**  
**PROJEKTUES : « STUDIO PROJEKT » shpk**



**TIRANË 2020**

**1**

**"STUDIOPROJEKT" sh.p.k Tirane**  
**Adresa: Rr. Ndre MJEDA, Rezidenca Eagle. Njesia 3006. Tirane**  
**Cel : 068 20 56654**  
**E-Mail : [studioprojekt@yahoo.it](mailto:studioprojekt@yahoo.it)**

**HIDRO ONE ENERGY**

**PERMBLEDHJA JO TEKNIKE E  
RAPORTIT TE VLERESIMIT TE  
NDIKIMIT NE MJEDIS  
PER AKTIVITETIN E NDERTIMIT DHE  
FUNKSIONIMIT TE HEC-it  
DOHOSHISHT 2**

(Sipas Ligjit nr.10 440 date 07.07.2011 "Per vleresimin e ndikimit ne mjedis" Shtojca 2 Kodi 3/ë)



**Vendndodhja e ushtrimit te aktivitetit : Fshati Dohoshisht, Peshkopi**

**INVESTITOR : HIDRO ONE ENERGY shpk**

**PROJEKTUES : « STUDIO PROJEKT » shpk**



**TIRANË 2020**

**1**

**«STUDIOPROJEKT» sh.p.k Tirane**

**Adresa: Rr. Ndre MJEDA, Rezidenca Eagle. Njesia 3006. Tirane**

**Cel : 068 20 56654**

**E-Mail : [studioprojekt@yahoo.it](mailto:studioprojekt@yahoo.it)**

**PERSHKRIMI I PROJEKTIT**

- a. Qellimi i projektit te propozuar
- b. Planimetria e vendodhjes se projektit , ku te pasqyrohen ne harte topografike siperfaqja e tokes se kerkuar, kufijte e siperfaqes,te shoqeruar me koordinatat sipas sistemit Kordinativ GAUS KRUGER, fotografi dhe te dhena per perdorimin eksiztues te siperfaqes se tokes qe do te perdoret perkohesisht apo perhere nga projekti gjate fazes se ndertimit apo funksionimit te veprimtarise
- c. informacion per qendrat e banuara ne zonen ku propozohet te zbatohet projekti , shoqeruar me fotografi dhe te dhena per distancen e tyre nga vendodhja e projektit te propozuar, si dhe percaktimin e njesise se qeverisjes vendore qe administron territorin ku propozohet projekti
- ç. Skicat dhe planimetrit e objekteve te projektit dhe strukturave te projektit si dhe menytrat dhe metodat qe do te perdoren per ndertimin e objekteve dhe strukturave te projektit
- d. Pershkrim i proceseve ndertimore dhe teknologjike , perfshire kapacitetin prodhues/perpunues , sasite e lendeve te para dhe produktet perfundimtare te projektit.
- dh. Infrastruktura e nevojshme per lidhjen me rrjetin elektrike, furnizimin me uje, shkarkimet e ujerave te ndotura dhe mbetjeve si dhe informacion per rruget ekzistuese te aksesit apo nevojten per hapje te rrugeve te reja
- e. Programi per ndertimin, kohezgjatjen e ndertimit, kohezgjatja e planifikuar e funksionimit te projektit, kohen e mundshme te perfundimit te funksionimit te projektit dhe faza e planifikuar per rehabilitimin e siperfaqes pas mbarimit te funksionimit te projektit
- ë. Lendet e para qe do te perdoren per ndertimin dhe menytra e sigurimit te tyre (materiale ndertimi, uje dhe energji).
- f. Informacion per lidhjet e mundshme te projektit me projekte te tjera ekzistuese perreth/prane zones te projektit
- g. Informacion per alternativat e marra ne konsiderate persa i takon perzgjedhjes se vendodhjes se projektit dhe teknologjise qe do perdoret
- gj. Te dhenat per perdorimin e lendeve te para gjate funksionimit , perfshire sasite e ujit te nevojshem , te energjise, lendve djegese dhe menyren e sigurimit te tyre
- h. Aktivitete te tjera qe mund te nevojiten per zbatimin e projektit , si ndertim i kampeve apo rezidencave etj.
- i. Informacion per lejet dhe licencat e nevojshme per projektin , te kerkuara nga legjislacioni ne fuqi si dhe institucionet kompetente per lejimin/ autorizimin/ licencimin e projektit
- j. kopje te lejeve , autorizimeve dhe licencave qe disponon zhvilluesi per projektin e propozuar, ne perputhje me percaktimet e bera ne legjislacionin ne fuqi, si dhe institucionet kompetente per lejimin/autorizimin/licencimin e projektit.

**a. Qellimi i projektit te propozuar**

Qellimi themelor i projektit eshte prodhimi i energjise elektrike te rinovueshme duke realizuar nje vleresim te pergjithshem te integruar dhe ne kohë te ndikimeve mjedisore të projektit me synim parandalimin dhe zbutjen e ndikimeve negative në mjedis.

Proçesi i vlerësimit te ndikimit ne mjedis do te jete i hapur dhe i administruar me paanshmëri, nëpërmjet pjesëmarrjes së plote te organeve qendrore e vendore, organizatave jofitimprurëse për mjedisin, publikut, propozuesit të projektit , grupit te interest dhe personave fizik e juridik, specialiste te kesaj fushe.

Me kete ide, synohet marrja në konçesion i ndërtimit të **HEC Dohoshisht 2** vënien në efijencë të potencialit energjistik nëpërmjet shfrytëzimit të energjisë hidrike që posedon zona e studimit.

**b. Planimetria e vendodhjes se projektit , ku te pasqyrohen ne harte topografike siperfaqja e tokes se kerkuar, kufijte e siperfaqes,te shoqeruar me koordinatat sipas sistemit Koordinativ GAUS KRUGER, fotografi dhe te dhena per perdorimin eksiztues te siperfaqes se tokes qe do te perdoret perkohesisht apo perhere nga projekti gjate fazes se ndertimit apo funksionimit te veprimtarise.**

Perroi i peshkopise fillimet e tij i ka ne vargmalin e Korabit ne kufi me Maqedonine e veriut. Baseni ujembledhes i ketij perroi fillon nga kuotat 2310 m, qafa e Skertecit, 2168 mmnd Livadhet e Zagradit, 2112 mmnd Shkalla e Serbit, 2250 Krajli Visoka, 2054 piramida 8/3, deri ne kufizim me lumin Drin I Zi rreth kuotes 389 mmnd te shtratit tij.

Nga ana e majte e rrjedhes tij ky perrua kufizohet me basenin ujembledhes te perroit Melanit kurse ne te djathte te rrjedhes me basenet e perroit te Grames, Shimcanit etj.

# HIDRO ONE ENERGY shpk





Fig. 1 Harta topografike e pellgut ujëmbledhës të përroit të Peshkopisë

“STUDIOPROJEKT” sh.p.k Tirane  
 Adresa: Rr. Ndre MJEDA, Rezidenca Eagle, Njesia 3006, Tirane  
 Cel : 068 20 56654  
 E-Mail : [studioprojekt@yahoo.it](mailto:studioprojekt@yahoo.it)

HARTA HIDROGJEOLOGJIKE E PELLGUT UJEMBLEDHES – HEC DOHOSHIJT 2



HARTA GJEOLOGJIKE E PELLGUT UJEMBLEDHES – HEC DOHOSHISHT 2



### **Hidrografia e zones**

Përroi i Peshkopisë nga veriperëndimi kufizohet me përroin e Deshatit dhe malin e Peshkopisë (2345m), nga jugu me përroin e Grevës dhe me malin e Illices (2004m) dhe në lindje me vijën kufitare me Maqedoninë, që është dhe vija ujëndarëse me pellgun e lumit Radika, dega kryesore e Drinit të Zi që derdhet në liqenin e HEC-it të Shpiljes (Dibra e Madhe, Maqedoni).

Përroi i Peshkopisë e ka zanafillën e tij nga mali i Peshkopisë. Mbasi kalon nëpër fshatin Cerjan dhe Bellovë drejtohet për në Llixhat e Peshkopisë dhe derdhet në Drinin e Zi në fshatin Selan.

Përroi i Peshkopisë (ose përroi i Llixhave) është vazhdimi i përroit të Cerjanit, që siç thamë me sipër është dhe fillimi i përroit të Peshkopisë, i cili bashkohet me përroin e Livadheve dhe rreth kuotës 800m m.n.d bashkohet dhe me përroin e Grabines dhe formojnë përroin e Peshkopisë.

Sipërfaqja e përgjithshme e përroit të Peshkopisë, deri në derdhje në lumin Drini i Zi, ka një sipërfaqe të pellgut ujëmbledhës  $F = 57.5 \text{ km}^2$  dhe gjatësi të përroit  $L = 9 \text{ km}$ .

Përroi i Peshkopisë, deri në aksin ku do të ndërtohet vepra e marrjes të he Hydrocentralit Dohohisht 2 ka një sipërfaqe të pellgut ujëmbledhës  $F = 40 \text{ km}^2$ , gjatësi të përroit  $L = 2.55 \text{ km}$  dhe pjerrësi mesatare të shtratit të përroit  $i_{\%}=51$  për mijë ose 5.1%.

Pellgu ujëmbledhës i përroit të Peshkopisë ka një rrjet hidrografik të zhvilluar. Ushqimi kryesor i këtij përroi janë reshjet atmosferike në forme shiu dhe bore kur periudha e plotave përputhet me periudhën e shirave por kur kombinohet me shkrirjen e bores në periudhën ciklonare me temperatura të larta, plotat në këtë përrua janë të rrezikshme.

Veprat Hidroteknike kanë keto Koordinata Gjeografike në Sistemin **Gauss-Kruger Zona 4**

HEC DOHOSHISHT 2 (OBJEKTET)	X	Y	Z
VEPRA MARJES	44 53 350.38	46 16 986.56	<b>+656.00</b>
NDERTESA CENTRALIT <a href="#">HEC DOHOSHISHT 2</a>	44 52 419.36	46 15 943.01	<b>+610.00</b>

Veprat Hidroteknike kanë keto Koordinata Gjeografike në Sistemin **KRGJSH**

HEC DOHOSHISHT 2 (OBJEKTET)	X	Y	Z
VEPRA MARJES	536476.85	4616795.23	<b>+656.00</b>
NDERTESA CENTRALIT <a href="#">HEC DOHOSHISHT 2</a>	535558.02	4615740.96	<b>+610.00</b>





**c. informacion per qendrat e banuara ne zonen ku propozohet te zbatohet projekti , shoqeruar me fotografi dhe te dhena per distancen e tyre nga vendodhja e projektit te propozuar, si dhe percaktimin e njesise se qeverisjes vendore qe administron territorin ku propozohet projekti**

Zona ku perfshihet projekti eshte nen juridiksionin e Qarkut Diber, Bashkia Diber. Vepra e marrjes eshte ne krahun e djathte te ures ne hyrje te qytetit ndersa ndertesa e centralit ne dalje te qytetit te Peshkopise ne afersi te rruges qe te con ne fshatin e Dohoshisht ne nje distance prej 400 m larg ne vije ajrore.

Fshati Dohoshisht ndodhet në jug të qytetit të Peshkopise, Vendndodhja strategjike e fshatit mes qytetit të Peshkopisë dhe lumit Drin e ka bërë një pike lidhëse për zhvillimin e tregtisë, bujqërisë dhe agrikulturës. Kjo vendndodhje i ka dhënë fshatit një peizazh mahnitës sidomos ne stinën e verës. Fshati ka rreth 2000 banore dhe konsiderohet si një nga fshatrat më të mendhenj të rrethit të Dibrës. për sa i përket bujqërisë dhe agrikulturës. Në të gjejmë shumë vreshta, frutore dhe toka pjellore të cilat janë pothuajse te gjitha të ujitshme. Gjithsesi, ekonomia e fshatareve sot varet shumë dhe nga të ardhurat e emigrantëve dhe ndonjë biznesi të vogël privat në Peshkopi dhe brenda përbrenda fshatit.




*Foto Nr.2 - Foto nga fshati Dohoshisht*

Qyteti i Peshkopise ndodhet ne brigjet e lumit Drin. Rrethi i Dibrës bën pjesë në rajonin veri-lindor me një relief përgjithësisht kodrinor-malor.Pra shtrihet në Veri-lindje të Shqipërisë në dy anët e luginës së Drinit të Zi duke u kufizuar në lindje nga vargmali i Korabit dhe në perëndim nga vargmalet e Lurës. Qendra e rrethit është qyteti i Peshkopisë.Qendra e rrethit (Peshkopia) shtrihet 185 km nga kryeqyteti dhe

21 km largësi nga pika e doganës së Bllatës në Maqellarë. Sipas të dhënave të INSTAT në rethin e Dibrës banojnë 75262 banorë në 15394 familje me rreth 4.9 anëtare për familje. Ka një dendësi 70 b/km<sup>2</sup>. Duke analizuar të dhënat del se nga rethi Dibër nga viti 1990 janë larguar 24106 banorë pasi në vitin 1990 ky reth kishte afro 99368 banorë. Kjo popullsi është vendosur në Tiranë 67 %,Durrës 21% dhe rrethe si:Lushnjë,Fier, Lezhë,Kavajë,deri Sarandë dhe Shkoder.

**ç. Skicat dhe planimetritë e objekteve të projektit dhe strukturave të projektit si dhe menyrat dhe metodat që do të përdoren për ndërtimin e objekteve dhe strukturave të projektit**

Skema e Shfrytëzimit të Pellgut Ujëmbledhës të Përroit të Peshkopisë, respektivisht në aksin e **V.Marrjes** nga kuota **▼+656.00 (m.n.d)** deri në kuotën **▼+610.00 (m.n.d)**, Tubacioni i Turbinave, Ndertesa e Centralit **HEC Dohoshisht 2** është paraqitur në figuren e mëposhtme Nr.5.



**Figura Nr.3 – Skema e Shfrytëzimit të Pellgut Ujëmbledhës të Përroit të Peshkopisë – HEC Dohoshisht 2**


**HEC DOHOSHISHT 2 - Vepra e Marrjes (Aksi 2-2)** Figura 6, do të ndërtohet në Përroitin e Peshkopisë, me kuotë të frontit kapërderdhës **▼+656.00 (m.n.d)**, në një zonë të zgjedhur mirë për nga

gjërësia e shtratit, qëndrueshmërisë së bazamentit shkëmbor në shtrat, si dhe mundësia e shkuarjes atje me rrugë aksesi. Më pas nëpërmjet Tubacionit të Turbinave (Aksi 1-2) Figura Nr.6, Çelik  $1\text{Ø}117.6/5.0\div 5.6\text{mm}$ , të vendosur në kuotën  $\nabla +655.30$  (m.n.d) dhe me gjatesi të përgjithëshme  $L_{1-2} = 1550$  ml, ujrart dërgohen për turbinim në turbinat e vendosura në Godinen e Centralit të HEC-it Dohoshisht 2 (Aksi 1-1) me kuotë të aksit të turbinave  $\nabla +610.00$  (m.n.d).

Per efekt letesimi transporti parashikohen tubacione celiku DN1200, DN1100 dhe DN1000 me gjatesi rreth 516 ml sejcili.

Në nisje të Tubacionit të Turbinave, është parashikuar për tu vendosur dhe Valvola e Sigurisë DN1100mm PN6 e cila siguron mbylljen automatike të linjës së Tubacionit të Turbinave në rast dëmtimi apo çarjeje.

Sipërfaqja e pellgut ujëmbledhës të HEC Dohoshisht 2 në aksin e V.Marrjes është  $W_2 = 40.00$  km<sup>2</sup>.




**Figura Nr.4** – Vepra e Marrjes (Aksi 2-2), në Perroin e Peshkopisë, HEC-i DOHOSHISHT 2 – rrethi Diber

Tubacioni i Turbinës  $1\text{Ø}1016/5.0\div 5.6\text{mm}$ , para hyrjes në turbinat e **HEC Dohoshisht 2** degëzohet në **2 tuba celiku DN800mm/5.4mm** ose  $2\text{Ø}812.8/5.4\text{mm}$ .

Tubacioni i Turbinave do të mbështetet apo inkastronet në një numër të konsiderueshëm ankera mbështetës dhe kryesore si në figurën e mëposhtme Nr.8.

Në fund të linjes së **Tubacionit të Turbinave (Aksi 1-2)**, është parashikuar **Ndertesa e Centralit të HEC Dohoshisht 2 (Aksi 1-1)**, (Figura 9) në të cilën do të vendosen **dy turbina Francis me Aks Horizontal me fuqi 350 kW** secila.



**Figura Nr.5** – Planimetria e Tubacionit të Turbinave (Aksi 1-2) HEC-i Dohoshisht 2 – Rrethi Diber




Figura Nr.6 – Ankeri Mbeshtetes Tip dhe Blloku i Ankorimit Tip




Figura Nr.7 – Planimetria e N. Centralit HEC Dohoshisht 2 (Aksi 1-1) – Bashkia Peshkopi




Figura Nr.8 – Planimetria e Brendeshme e N.Centralit HEC Dohoshisht 2 (Aksi 1-1) Bashkia Peshkopi




Figura Nr.9 – Prerja Terthore e N.Centralit HEC Dohoshisht 2 (Aksi 1-1) Bashkia Peshkopi

**“STUDIOPROJEKT” sh.p.k Tirane**  
Adresa: **Rr. Ndre MJEDA, Rezidenca Eagle, Njesia 3006, Tirane**  
Cel : 068 20 56654  
E-Mail : [studioprojekt@yahoo.it](mailto:studioprojekt@yahoo.it)

Ne Ndertesen e Centralit **HEC Dohoshisht 2** jane parashikuar te vendosen **2 Turbina Francis (2x350kW) = 700 Kw**

Kuota e Aksit te vendosjes se turbinave **▼+610.00 (m.n.d)**, ndersa niveli normal I ujit (N.N.U) ne Kanalin e Shkarkimit do te jete **▼+609.51 (m.n.d)**.

Kuota relative  $\pm 0.00$  e Nderteses se Centralit I korenspondon **▼+608.74**

**d. Pershkrim i proceseve ndertimore dhe teknologjike, perfshire kapacitetin prodhues/perpunues , sasite e lendeve te para dhe produktet perfundimtare te projektit.**

#### **Vepra e Marjes ne perroIn e Peshkopise**

Vepra e Marjes do te ndertohet ne nje gryke relativisht te gjere ne kuoten **▼+656.00 m.m.n.d** ne perrojin e Peshkopise mbi depozitimet proluvialo-aluviale te ketij perroji qe kane nje trashesi qe luhetet nga **3.0** deri ne **5.0 m**. Nen keto depozitime kemi depozitimet e taraces te perbera nga suargjila zhavorrore qe paraqesin nje trashesi te konsiderushme. Nen keto depozitime kemi depozitimet e Triasikut te poshtem-te mesem te perfaqesuar nga gelqerore-reshpore dhe gelqerore-ranorik.

#### **Tubacioni i Turbines**

Nga Vepra e Marrjes te **HEC Dohoshisht 2** ujrat me anen e Tubacionit te Turbinave **Ø1100mm** (diametri mesatar qe do te perdoret) do te kalojne Ndertesen e Centralit. Ky tubacion do te kete nje gjatesi prej rreth **1550 ml**. Tubacioni do te shtrihet ne afersi te shtratit te lumit ne nje zone te qete, mbi depozitimet e perziera deluvialo-eluviale si dhe aluvialo-proluviale ( taracat e Pleistocen-Olocenit) te Kuaternarit, te perbera nga suargjila me copra shkembijsh te shkateruar (depozitimet deluvialo-eluviale) si dhe suargjila zhavorrore (taracat e Pleistocen-Olocenit). Trashesia e depozitimeve te taracave te Pleistocen-Olocenit eshte e konsiderushme. Nen depozitimet mbulesore ne pjesen e pare te trasese se tubacionit kemi depozitimet e Triasikut te poshtem-te mesem te perfaqesuar nga gelqerore-reshpore dhe gelqerore-ranorik. Ne segmentin e dyte traseja kalon ne depozitimet e perziera proluvialo-aluviale te Kuaternarit (taracat e Pleistocen-Olocenit) te cilat paraqesin nje trashesi te konsiderushme..

#### **Ndertesa e Centralit te HEC Dohoshisht 2**

Ndertesa e Centralit te HEC Dohoshisht 2 do te ndertohet ne kuoten **▼+610.00 m.m.n.d**, ne ne nje zone te qete mbi depozitimet flishoidale te Titonian-Cenomanianit te perfaqesuara nga ranore-mergelore, qe paraqesin nje mbulesa deluvialo-eluviale me nje trashesi qe luhetet nga **1.5** e deri ne **3.0m**. Kjo veper nuk paraqet probleme gjeologo-inxhinerike.



**HEC DOHOSHISHT 2**

☞ Niveli Normal i Ujit ne Vepren e Marrjes	+656.00 (m.n.d)
☞ Kuota e Aksit te Tubacionit ne N.Centralit	+610.00 (m.n.d)
☞ Kuota e Nivelit Normal te Ujit ne Kanalim e Shkarkimit	+610.20 (m.n.d)
☞ Renia Brutto e HEC-it	46.00 ml
☞ Humbjet e Pergjitheshme ne Tubacion	3.40 ml
☞ Renia Netto e HEC-it	42.60 ml
☞ Gjatesia e Linjes se Tubacionit te Turbinave	L = 1550 ml

**PARAMETRAT HIDROSTATIKE DHE HIDROENERGJITIKE TE HEC-it DOHOSHISHT 2**

Q <sub>mes</sub>	1.225	m <sup>3</sup> /sek	Prurja mesatare shumëvjeçare e V.Marrjes ne P.Peshkopise
Q <sub>log50%</sub>	1.785	m <sup>3</sup> /sek	Prurja llogaritëse viti mesatar shumëvjeçar
Q <sub>log25%</sub>	2.193	m <sup>3</sup> /sek	Prurja llogaritëse viti i lagësht
Q <sub>log75%</sub>	1.360	m <sup>3</sup> /sek	Prurja llogaritëse viti i thatë
Q <sub>ekomes</sub>	0.168	m <sup>3</sup> /sek	Prurja mesatare ekologjike vitin mes.shumëvjeçar
H <sub>brutto</sub>	48.00	ml	Rënia brutto e HEC-it
H <sub>netto</sub>	<b>44.60</b>	ml	Rënia netto e HEC-it
ΔH	<b>3.40</b>	ml	Humbjet e pergjitheshme hidraulike
V <sub>t</sub>	<b>30.719.244</b>	<b>m<sup>3</sup></b>	Volumi vjetor i ujit që do të turbinohet
N <sub>v</sub>	<b>700</b>	kW	Fuqia e Vendosur e HEC-it
E <sub>50%</sub>	<b>1.914.080</b>	kWh ne vit	Energjia Elektrike vjetore që prodhon HEC-I për vitin mes.shumëvjeçar
E <sub>25%</sub>	2.137.453	kWh ne vit	Energjia Elektrike vjetore që prodhon HEC-I për vitin e lagësht
E <sub>75%</sub>	1.280.137	kWh ne vit	Energjia Elektrike vjetore që prodhon HEC-I për vitin e thatë
T <sub>50%</sub>	<b>2.734</b>	ore pune ne vit	Orë Pune vjetore të parashikuara të HEC-it për vitin mes.shumëvjeçar
T <sub>25%</sub>	3.054	ore pune ne vit	Orë Pune vjetore të parashikuara të HEC-it për vitin e lagësht
T <sub>75%</sub>	1.829	ore pune ne vit	Orë Pune vjetore të parashikuara të HEC-it për vitin e thatë
η <sub>v</sub>	<b>0.80</b>		Koefiçenti i shfrytëzimit të rrjedhjes ujore
η <sub>N</sub>	<b>0.62</b>		Koefiçenti i shfrytëzimit të fuqisë
η <sub>E</sub>	<b>0.53</b>		Koefiçenti i shfrytëzimit të energjisë
η <sub>T</sub>	<b>0.31</b>		Koefiçenti i shfrytëzimit të orëve të punës

**Prurja Ekologjike**

Llogaritja e sakte e prurjes ekologjike kërkon një studim të vecante në aksin e vepres së marrjes së **HEC-it Dohoshisht 2**, por nisur nga praktika e deritanishme e dhenieve të Lejeve Mjedisore dhe Lejes së përdorimit të burimit ujor për prodhimin e energjisë elektrike, kemi bërë llogaritjen e prurjes ekologjike

nisur nga kurba e qendrueshmerise se prurjes ne cdo aks te veprave te marrjes, per vitin mesatar shumevjecar.

Ne rastin konkret, gjithmone nisur nga praktikat e deritanishme te Ministrise se Mjedisit do te leme ne lume prurjen ekologjike  $Q_{ek} = Q(355 \text{ ditore})$  ne tabelen e Kurbes se Qendrueshmerise se prurjeve e cila eshte **0.165 m<sup>3</sup>/sek**

Ne Tabelene e meposhteme eshte paraqitur shperndarja mujore per vitin mesatar shumevjecar te prurjes ekologjike, nga ku verejme qe prurja ekologjike mesatare vjetore eshte:

Per **Aksin 2-2** Vepra e Marrjes P.Peshkopise  $Q_{ek} = 165 \text{ l/sek} = 0.165 \text{ m}^3/\text{sek}$

Prurjet Ekologjike te llogaritura jane rreth **13.75%** e prurjes mesatare per vitin mesatar shumevjecar.

Llogaritja e sakte e prurjes ekologjike kerkon nje studim te vecante ne aksin e vepres se marrjes **HEC-it Dohohisht 2**, por nisur nga praktika e deritanishme e dhenieve te Lejeve Mjedisore dhe Lejes se perdorimit te burimit ujoj per prodhimin e energjise elektrike, kemi bere llogaritjene e prurjes ekologjike nisur nga kurba e qendrueshmerise se prurjes ne cdo aks te veprave te marrjes, per vitin mesatar shumevjecar.

Ne rastin konkret, gjithmone nisur nga praktikat e deritanishme te Ministrise se Mjedisit do te leme ne lume prurjen ekologjike  $Q_{ek} = 355 \text{ ditore}$  ne **Tabelen Nr.11**, ate te kurbes se qendrueshmerise se prurjes ne Aksin e V.Marrjes

Per **Aksin 2-2** - Vepra e Marrjes - **HEC Dohohisht 2**  $Q_{ek} = 168 \text{ l/sek} = 0.168 \text{ m}^3/\text{sek}$


Prurjet Ekologjike te llogaritura jane rreth **13.75%** e prurjes mesatare per vitin mesatar shumevjecar.

**ULLOGARITJA E PRURJES EKOLOGJIKE MUJORE NE FUNKSION TE PRURJES NATYRALE NE AKSET E V.MARRJES**

Tabela Nr.11

Muajt	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII	MES VJETORE
Qmes Aksi 2-2	0.927	0.962	1.155	2.466	2.805	1.363	0.630	0.425	0.512	0.771	1.356	1.332	<b>1.225</b>
Dite	31	28	31	30	31	30	31	31	30	31	30	31	<b>365</b>
sek/1 dite	86.400	86.400	86.400	86.400	86.400	86.400	86.400	86.400	86.400	86.400	86.400	86.400	<b>86.400</b>
Qmuajore	2.482.877	2.326.278	3.094.332	6.392.483	7.513.483	3.532.452	1.686.133	1.139.530	1.326.911	2.065.976	3.514.521	3.566.820	<b>38.641.796</b>
R=Qek/Qnat	13.75%	13.75%	13.75%	13.75%	13.75%	13.75%	13.75%	13.75%	13.75%	13.75%	13.75%	13.75%	<b>13.75%</b>
Qmuajore*R	341.396	319.863	425.471	878.966	1.033.104	485.712	231.843	156.685	182.450	284.072	483.247	490.438	<b>5.313.247</b>
Qek Muj 2-2	0.127	0.132	0.159	0.339	0.386	0.187	0.087	0.058	0.070	0.106	0.186	0.183	<b>0.168</b>

Muajt	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII	MES VJETORE
Qmes Aksi 2-2	0.927	0.962	1.155	2.466	2.805	1.363	0.630	0.425	0.512	0.771	1.356	1.332	<b>1.225</b>
Qek Muj 2-2	0.127	0.132	0.159	0.339	0.386	0.187	0.087	0.058	0.070	0.106	0.186	0.183	<b>0.168</b>
Qmes1 - Qek1	0.800	0.829	0.996	2.127	2.419	1.175	0.543	0.367	0.442	0.665	1.169	1.149	<b>1.057</b>



**dh. Infrastruktura e nevojshme per lidhjen me rrjetin elektrike, furnizimin me uje, shkarkimet e ujerave te ndotura dhe mbetjeve si dhe informacion per rruget ekzistuese te aksesit apo nevojten per hapje te rrugeve te reja**

### **VESHTRIM MBI RRJETIN ELEKTRIK TE ZONES**

Territori ku do te ndertohet hidrocentrali ndodhet ne nje zone ku infrastruktura e rrjetit nuk eshte shume e zhvilluar ne nje zone ku per nje kohe te gjate nuk jane bere investime ne drejtim te permisimit te rrjetit dhe rritjes se sigurise se furnizimit. Ne zonen e Peshkopise jane ndertuar disa hidrocentrale te ndryshme qe jane lidhur ne nenstacionin e Peshkopise.

**Hidrocentrali i Dohoshisht 2** ka nje fuqi relativisht te vogel e cila nuk ka ndikim ne ekuilibrat e rrjetit elektroenergjetik te zones si dhe as ndikim ne ndryshimin e niveleve te tensionit.

### **Opsionet e mundshme me lidhjen me rrjetin e SE**

Gjate hartimit te varianteve per lidhjen e hidrocentralit me sistemin do te trajtojme investimet e nevojshme, nivelin e tensionit te pikes se lidhjes, humbjet e energjise, kapacitetin transmetues te pikes se lidhjes dhe sigurine e operimit.

Si konkluzion do te zgjedhim variantin me te mire qe ploteson me mire kerkesat e mesiperme.

Nisur nga planimetrit e vendosjes se hidrocentralit dhe distanca me pikat e mundshme te lidhjes me sistemin elektroenergjetik **HEC Dohoshisht 2 do te lidhet me zbarrat e nenstacionit te Peshkopise, ne nje gjatesi te pergjitheshme linjei prej L=1400m.**

### **Lidhja me rrjetin 10 kV te zones**

Fidri 10 kV i zones eshte ne nje distance prej 1,5 km nga Hec-i. Fidri 10 kV sebashku me degezimet e tij eshte shume i gjate. Ngarkesa gjate nates e ketij fidri eshte e vogel sepse zona nuk ka industri te zhvilluar dhe konsumatoret kryesore jane konsumatoret familjar dhe turizmi ne periodha te caktuara te vitit.

Percjellesi i linjes ajrore 10 kV eshte i ndryshem duke filluar nga 25 mm<sup>2</sup> deri ne 50 mm<sup>2</sup>. Faktet e mesiperme tregojne qe kjo linje e ka te pamundur te perballoje transmetimin e sigurte te energjise se prodhuar nga **Hec-i i Dohoshisht 2.**

Pervec kesaj gjatesia e madhe e linjes dhe klima malore e zones me rreshje bore ne periudhen e dimrit nuk ofrojne sigurine e nevojshme per nje transmetim te sigurte te energjise se prodhuar.

Lidhja me rrjetin 10 kV te zones eshte e pamundur per shkak te sigures se transmetimit si dhe te pamundesise se saj per transmetimin e energjise se prodhuar.

### **Lidhja me rrjetin 110 kV**

Per arsye te fuqise se vogel te instaluar lidhja me rrjetin e tensionit 110 kV nuk merret ne analize per shkak te kostove shume te medha te lidhjes.

### **Lidhja me zbarat 10 kV te nenstacionit te Peshkopise**

Ne baze te analizes se mesiperme rezulton qe opsioni me ekonomik dhe me i sigurte eshte lidhja me nje linje ajrore 10 kV me zbarat e nenstacionit te Peshkopise duke vendosur nje cele te re 10 kV ose duke perdorur nje cele egzistuese te nenstacionit.

Linja 10 kV do te jete afersishte me gjatesi **1.4 km** me percjelles alumin celik me seksion te percjellesit 3x180 mm<sup>2</sup>. Ne nje rast te tille reniet e tensionit do te jene ne nje vlere te pranueshme prej 2,7%.

Per ndertimin e nje linje ajrore eshte e nevojshme te behet studimi topografik i zones per te pare mundesine e rrugeve te aksesit per montimin e shtyllave betonarme.

Ne nje faze te mevonshme ne bashkepunim me pushtetin lokal dhe specialistet e OSHEE do te merret ne konsiderate dhe ndertimi i nje linje kabllore 10 kV.

Linja ajrore mund te ndertohet me shtylla beton arme me gjatesi 9 dhe 12 meter ne varesi te terrenit. Tranversat do te jene metalike me vendosje horizontale te percjellesi. Per shkak te peshes se percjellesit ne shtyllat kendore cdo percjelles do te fiksohet ne nje grilande terheqese me dy izolatore tip kembane.

Ne rast te ndertimit te nje linje kabllore do te ishte e mjaftueshme nje linje kabllore me kabell alumini XLPE 3 x180 mm<sup>2</sup>. Linja kabllore ka kosto me te larte por sjell nje transmetim energji me te sigurte dhe nje numer defektesh shume here me te ulet se linja ajrore.

### **Te dhenat teknike te Hec Dohoshisht 2**

Fuqia e instaluar **2 x 350 kw**

Prodhimi vjetor **1.914 milion kwh**

HEC Dohoshisht 2 do te kete **dy gjeneratore me fuqi te instaluar 400 kW.**

**Dy transformatore** ngrites te lidhur ne bllok me gjeneratoret 0,69/10 kV **me fuqi 500 kVA**

Transformatorin e nevojave vetjake 10/0,4 50 kVA



Zbarat 10 kV te perbera nga celat e celsave 10 kV te daljeve te transformatoreve 10 kV, cela e transformatorit te nevoja vetjake, cela e matjes se enegjise si dhe cela per linjen dalje 10 kV ne drejtime te nenstacionit te Peshkopise

HEC-i do te kete **dy turbina Francis 350 kW sejcila** qe te sigurojne nje diagram pune per sasi te ndryshme te prurjeve ne varesi te kushteve atmosferike.

Gjeneroret e cdo turbine do te jene me nje tension ne dalje 690 Volt dhe numer xhirosh 1000 rpm.

Transformoret ngrites do te jene **400 kVA** me tension 0.69/10 kV.

Transformatori i nevojave vetjake do te jete **50 kVA** dhe tension 10/0.4 kV.

Se bashku me linjen 10 kV per lidhjen me nenstacionin e Peshkopise do te shtrihet dhe nje linje me fiber optike. Ne bashkepunim me OST do te behet e mundur lidhja me fiber optike te **hidrocentralit te Dohoshishtit 2** me sistemin SCADA me qellim monitorimin dhe kontrollin e parametrave dhe energjise se prodhuar nga hidrocentrali.

